



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:007029

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 06000181

C.nr.3/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA E GJYKATËS MALISHEVË
Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Nehat Qelaj, në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve „ E. „ sh.a, me seli në Prishtinë, rruga 2 korriku, nr.4 kundër të paditurit H.I.Gnga fshati G. , K. Malishevës , për Rimbursim dëmi , vlera 275 euro jashtë seance, më datë 30.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Konstatohet** se është **TËRHEQUR** padia e Paditëses Kompania e Sigurimeve „ E. „ sh.a, me seli në Prishtinë e ushtruar me datë 04.01.2023 kundër të paditurit H.I.Gnga fshati G. , K. Malishevës , për Rimbursim dëmi , vlera 275 euro.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësja e lartpërmendur, në këtë Gjykatë me datë 04.01.2023 ka parashtruar padinë dhe kërkesëpadinë kundër të paditurit H.I.Gnga fshati G. , K. Malishevës , për Rimbursim dëmi , vlera 275 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë i ka dërguar të paditurit Aktvendimin për përgjigje në padi datës 10.05.2024 së bashku me padinë dhe provat e padisë e pranuar me datë 22.05.2024 mirëpo i padituri nuk kanë parashtruar përgjigje në padi.

Paditësja me datë 23.05.2024 ka deponuar parashtrësën mbi Tërheqjen e padisë duke theksuar se palët ndërgjyqëse me datë 20.03.2024 kanë arritur ujdj jashtë gjyqësore sipas vlerës së kontestit si në padi, prandaj e tërheqin padinë pasi që me marrëveshje jashtëgjyqësore janë kompensuar të gjitha format e dëmit si në padi.

Meqenëse i padituri nuk ka parashtruar përgjigje në padi, Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së paditësit, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 261 të LPK-së për tërheqje padis dhe 450 të LPK-së për shpenzimet e procedurës.

Gjykata Themelore Gjakove-Dega Malishevë.
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C. nr. 3/2023, dt.30.07.2024

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet parashtrimi i ankesës.